



DEGA NË LIPJAN-OGRAK LIPLJAN

P.nr.77/17

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- DEGA NË LIPJAN**, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen bashkëpunëtores profesionale Elvira Emini, në çështjen penale ndaj të pandehurit H. K. nga fsh. B. i Z. K. L., të cilin e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP/II.nr.3910/2016 të dt 30.01.2017, për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, duke vendosur për dhënien e urdhrin ndëshkimor, jashtë seancës gjyqësore, me dt.**15.03.2017** merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**PRANOHET** kërkesa e PTH-së në Prishtinë, PP/II.nr.3910/2016 të dt 30.01.2017, dhe kjo gjykatë jep këtë:

**URDHËR NDËSHKIMOR**

Ndaj të pandehurit: H. K., nga i ati Xh., dhe e ëma H., i lindur më dt. *data e lindjes...*, me vendbanim në fsh. B. i Z. K. L., shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës,

**Ë S H T Ë F A J T O R**

**Sepse:**

Me datë 27.06.2016, rreth orës 17:35h, në rrugën e fshatit B. i Z., i pandehuri derisa ka qenë duke drejtuar automjetin e tipit “Opel Omega”, me targa të regjistrimit *numër i targave...*, ngjyrë e kaltër, nga pakujdesia, ka shkel ligjin mbi trafikun publik, ka rrezikuar jetën dhe ka dëmtuar trupin e njeriut, në atë mënyrë që ka vepruar në kundërshtim me nenin 126 par. 1 të Ligjit për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor, duke mos shpejtësinë e lëvizjes së automjetit kushteve në rrugë, duke mos mbajtur distancën e sigurisë në mes të automjeteve, me pjesën e përparme e godet qerren tërheqëse në pjesën e pasme, të cilën e drejtonte i dëmtuari S. Z., me ç’rast lëndime të lehta trupore pëson tani i dëmtuari S. Z.,-

-me këtë ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata, në konform dispozitave të neneve 1, 2, 3, 4, 6, 17, 23, 41, 42, 43, 46, 73, 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së dhe neneve 493, 495 dhe 365 të KPPK-së, të pandehurin e gjykon me,

**DËNIM ME GJOBË**

Me dënim me gjobë në shumë prej **200-€ (dyqindëeuro)**, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta paguaj, në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykim.

Në rast se dënimi nuk realizohet as me detyrim, gjykata dënimin me gjobë do ta zëvendësojë konform nenit 46 par.3 të KPRK-së, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burg, të llogaritet shuma prej 20-€.

**I dëmtuari**, S. Z. nga fsh. G. i E. K. Sh., udhëzohet që kërkesën pasurore-juridike ta realizoj në procedurë të rregullt gjyqësore.

**DETYROHET** i akuzuari në emër të shpenzimeve të procedurës penale kësaj gjykate t'ia paguajë, shumën prej 60.88-€, si dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor shumën prej 20-€, në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë me aktakuzën e saj PP/II.nr.3910/2016 të dt 30.01.2017 e ka akuzuar të pandehurin H. K., për shkak të veprës penale, Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe njëkohësisht ka kërkuar që të pandehurit ti shqiptohet urdhër ndëshkimor – dënim me gjobë për veprën e lartcekur penale.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi shqyrtoi provat që i janë bashkangjitur aktakuzës respektivisht kallëzimit penal të dt.15.07.2016, Mendimin e ekspertit mjeko-ligjor Dr. M. G. të dt. 03.12.2016, dhe Mendimi dhe konstatimi i ekspertit të Komunikacionit ing. F. B. të dt. 24.10.2016, si dhe foto dokumentacioni dhe shkresat tjera të lëndës, erdhi në përfundim se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal lidhur me bazueshmërinë e aktakuzës, në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri vërtetë ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, prandaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me dispozitën e nenit 493 të KPPK-së parashihet se “Për vepra penale e cila parashihet dënimi me gjobë ose burgim deri në 3 (tre) vite, për të cilat prokurori i shtetit është i informuar me provat e besueshme nga kallëzimi penal, prokurori i shtetit mund të kërkojë në aktakuzë që gjykata të jep urdhër ndëshkimor, në të cilin të akuzuarit do ti shqiptoi dënim përkatës pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor”.

Gjyqtari me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes konform nenit 493 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor ndaj të akuzuarit nga arsyet se dënimi për veprën penale me të cilën ngarkohet i akuzuari është dënim me gjobë apo me burgim deri në 3 (tri) vite, andaj gjykata konform dispozitave të lartcekura vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor u bazua konform nenit 450 par. 2 nën par. 2.1. dhe nën par. 2.6 të KPPK-së.

Vendimi mbi realizimin e kërkesës pasurore- juridike, u bazua konform nenit 463 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- DEGA NË LIPJAN**

**P.nr.77/17, me dt.15.03.2017**

**Bashkëpunëtorja Profesionale**

Elvira Emini

**GJYQTARI**

Avdirrahman Gashi

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë në kundërshtim në afat prej 8 (tetë) dite nga dita e dorëzimit të të njëjtit, kundërshtimi i drejtohet kësaj gjykate.